

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXII, nr. 6580
E premte, 8 prill 2022
çmimi 0.40 €

NATO-ja: Do ta shtojmë mbështetjen për Ukrainën



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABRBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

KËSHILLI I INVESTITORËVE EVROPIANË (EIC) TË ENJTEN KA ORGANIZUAR KONFERENCË NË GJASHTËVJETORIN E HYRJES NË FUQI TË MARRËVESHJES SË STABILIZIM ASOCIIMIT (MSA)

BE-ja KËRKON NGA QEVERIA T'I PËRMBUSHË TË GJITHA OBLIGIMET E MSA-S



Me rastin e gjashtëvjetorit të hyrjes në fuqi të Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit (MSA), shef i Zyrës së BE-së, Tomas Szunyog, ka thënë se falë këtij mekanizimi Kosova ka zhvilluar procese shumë të rëndësishme në sektorët e drejtësisë, tregtisë, arsimit dhe punësimit. Ai ka theksuar se sa më shumë të zbatohet MSA-ja, aq më shumë do të përfitojë Kosova. Szunyog ka thënë se roli i Qeverisë së Kosovës është ta udhëheqë dhe ta sigurojë përmbushjen e të gjitha obligimeve që rrjedhin nga MSA-ja. Ndërkaq zëvendëskryeministri i Kosovës, Besnik Bislimi, ka siguruar se kanë ndërmarrë të gjitha hapat për zbatim të MSA-s duke filluar nga hartimi i ligjeve

AKTUALE



KURTI MERR PJESË NË FORUMIN EKONOMIK DELPHI, TAKON PERSONALITETE TË NDRYSHME F. 5

ARRIN NË PROKURORINË SPECIALE EKSPERTIZA SHITESË PËR RASTIN DEHARI F. 3

24 % E VDEKJEVE NË BOTË TË LIDHURA ME SHKAQET MJEDISORE F. 7

EKONOMI



INFLACIONI MUND TË RRIET EDHE MË SHUMË F. 8

ALIU: RRUGA PRISHTINË - PODUJEVË PRITET TË PËRFUNDOJË BRENDA DY MUAJVE F. 8

SPORT



PRISHTINA DHE DRITA FITOJNË GJYSMËFINALET E PARA F. 10

Reagim i KMDLNj-së

Gjykata Speciale: Hyp se t'vrava, zhdryp se t'vrava!



ZHGËNJIM ME PROCESIN E KPK-së PËR KRYEPROKUROR TË SHTETIT

FAQE 5

RENOVA
PUTZ
Magedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 735
Fax: +389 44 487 200
Mbr: +377 44 501 289
E-mail: renova@ml.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjbiznesi.com
info@kolegjbiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

NATO-ja: Do ta shtojmë mbështetjen për Ukrainën

BRUKSEL, 7 PRILL - Vendet anëtare të NATO-ja janë pajtuar për ta rritur mbështetjen për Ukrainën dhe do të dërgojnë disa lloje të sistemeve të armëve në këtë shtet, ka thënë sekretari i përgjithshëm i NATO-s, Jens Stoltenberg, të enjten, më 7 prill, pas një takimi të ministrave të Jashtëm.

Stoltenberg u ka thënë gazetarëve se vendet anëtare të NATO-s janë pajtuar për të bërë më shumë për t'u ndihmuar partnerëve të tjerë që t'i rritin aftësitë për ta mbrojtur veten, përfshirë Gjeorgjinë dhe Bosnjë Hercegovinën.

As Gjeorgjia, as Bosnjë Hercegovina nuk janë pjesë e NATO-s.

Stoltenbergu ka thënë se lufta në Ukrainë mund të zgjasë për javë, muaj apo edhe vite, duke shtuar se aleatët janë duke ndëshkuar Rusinë me “kosto të mëdha” në mënyrë që shkurtohet koha e konfliktit. Ai ka shtuar se nëse lufta do të vazhdojë për kohë të gjatë, rreziku kryesor është që njerëzit e Ukrainës “do të vuajnë më shumë dhe do të shohim më shumë vdekje dhe shkatërrim”.

“Natyrsh, për aq kohë sa lufta vazhdon, do të ketë rrezik për përshkallëzim përtej Ukrainës,

dhe kjo është ajo në të cilën fokusohet NATO-ja, ta parandalojë përshkallëzimin”, ka thënë ai.

Ministri i Jashtëm ukrainas, Dmytro Kuleba, ka thënë se shtetit të tij i duhen urgjentisht më shumë armë nga aleatët e Perëndimit për ta mbrojtur veten nga Rusia. “Aleatët janë duke ofruar më shumë armë dhe janë të gatshëm të bëjnë më shumë kur është fjala për mbështetje ushtarake”, ka thënë Stoltenbergu.

Rusia është duke u përballur me situatën më të vështirë në tri dekada për shkak të sanksioneve të pashembullta, mirëpo përpjekjet e huaja për të izoluar atë nga ekonomia globale do të dështojnë, ka thënë kryeministri rus Mikhail Mishustin më 7 prill. I cituar nga agjencia ruse e lajmeve, TASS, ai ka thënë se kjo situatë ka hapur dyert për mundësi të reja, pasi largimi i disa kompanive të huaja nga Rusia do të krijojë hapësirë për të tjerat.

Presidenti rus, Vladimir Putin, ka urdhëruar pushtimin e Ukrainës më 24 shkurt.

Ai ka urdhëruar “operacion special” për ta çmilitarizuar Ukrainën.



Veprimi i Kremlinit ka nxitur zemërim dhe është dënuar në shumë vende të botës. Shtetet e Bashkuara dhe aleatët

janë përgjigjur me sanksione të ashpra kundër Moskës.

G7-a dënon “mizoritë ruse” në Buça

Ottawa, 7 prill - Grupi i shtatë shteteve më të industrializuara (G7) ka dënuar “rëndë” ato që i ka konsideruar “mizori” të kryera nga Rusia në qytezën Buça dhe rajone të tjera të Ukrainës. “Imazhet e vdekjeve, viktimave të torturës dhe ekzekutimet, si dhe raportimet për dhunë seksuale dhe shkatërrim të infrastrukturës civile, tregojnë fytyrën e luftës brutale të Rusisë kundër Ukrainës dhe popullit të saj”, ka thënë G7 në një deklaratë të lëshuar më 7 prill.

“Masakrat në qytezën Buça dhe qyteza të tjera do të shtohen në listën e mizorive dhe në listën e shkeljeve të ligjit ndërkombëtar, duke përfshirë Ligjin për të Drejtat e Njeriut, të cilat janë kryer nga agresori në tokën

ukrainase”, është thënë në deklaratë.

Imazhet nga Buça, qytezë në verilindje të Kievit, janë bërë publike këtë javë.

Zyrtarët lokalë kanë thënë që më shumë se 300 njerëz janë vrarë nga forcat ruse vetëm në Buça dhe rreth 50 prej tyre janë ekzekutuar. Moskë ka hedhur poshtë këto dyshime.

Grupi i G7-s, që përbëhet nga Kanadaja, Franca, Gjermania, Italia, Japonia, Mbretëria e Bashkuar dhe Shtetet e Bashkuara, ka thënë përmes një deklaratë se është i gatshëm t'i ndihmojë Ukrainës për mbrojtjen e vetvetes nga pushtimi i paprovokuar rus, “duke përfshirë dërgimin e pajisjeve ushtarake dhe ndihmën financiare”. Mes të tjerash, në deklaratë është thënë se G7-ta do të vazhdojë ta rrisë presionin ndaj Rusisë, duke vendosur masa kufizuese për t'i penguar kapacitetet ruse për ta vazhduar agresionin kundër Ukrainës.



Austria dëbon diplomatë rusë

VJEN, 7 PRILL - Një zëdhënëse e ministrit të Jashtëm austriak Alexander Schallenberg njoftoi më 7 prill se katër diplomatë rusë janë detyruar të largohen nga shteti për shkak të sjelljes së tyre në kundërshtim të statusit diplomatik.

Austria është shteti i fundit në mesin e shumë shteteve të Bashkimit Evropian që kanë marrë vendime të ngjashme gjatë kësaj jave.

Për dallim nga shtetet e tjera të

BE-së, përfshirë Francën, Italinë dhe Gjermaninë, Austria nuk tregoi nëse ky vendim ishte për shkak të pushtimit të paprovokuar rus të Ukrainës dhe mizorive të pretenduara ruse në Ukrainë. Austria tha se diplomatët e Ambasadës ruse në Salzburg duhet të largohen nga shteti deri më 12 prill.

Shtetet e BE-së kanë dëbuar diplomatë rusë pas dënimit ndërkombëtar të mizorive që

pretendohet se forcat ruse kanë kryer ndaj civilëve ukrainas në Buça në veri të Kievit.

Nga Buça janë publikuar fotografi të civilëve të vrarë të shtrirë në rrugë, ku disa prej tyre kishin edhe duart e lidhura pas shpine.

Rusia ka mohuar se trupat e saj i kanë kryer këto vrasje dhe që prej fillimit të pushtimit, më 24 shkurt, mohon se shënjestron civilët.



Arrin në Prokurorinë Speciale ekspertiza shtesë për rastin Dehari

PRISHTINË, 7 PRILL (ER) - Në Prokurorinë Speciale të Kosovës ka arritur ekspertiza shtesë në rastin e ish-aktivistit të Lëvizjes Vetëvendosje, Astrit Dehari, ka njoftuar avokati Tomë Gashi në "Facebook". Gashi ka thënë se nuk e dinë se çfarë është shkruar në ekspertizën shtesë, të cilën, sipas tij, e kanë pritur që nga tetori i vitit 2020, duke shtuar se

janë të sigurt se ekspertiza shtesë do ta konfirmojë ekspertizën e shtatorit të vitit 2019. "Ekspertiza e Institutit të Mjekësisë Ligjore në Lozanë të Zvicrës, e shtatorit të vitit 2019, ka eliminuar edhe hipotezën e vetëvrasjes së Astrit Deharit. Hipoteza e vetëvrasjes së z. Astrit Dehari me mjetet e paraqitura nga mjekët ligjorë nuk duket e vërtetë. Për këtë

arsye rrethanat e vdekjes së z. Astrit Dehari janë, sipas mendimit tonë, të përfshira me një dyshim të intervenimit të personit të tretë në procesin fatal...", thuhet në ekspertizën e vitit 2019, sipas Gashit. Astrit Dehari është gjetur i vdekur në qendrën e paraburgimit në Prizren më 5 nëntor 2016 në rrethana që ende vazhdojnë të jenë të paqarta.



Reagim i KMDLNj-së

Gjykata Speciale: Hyp se t'vrava, zhdryp se t'vrava!

Gjykata e Apelit e Gjykatës Speciale Ndërkombëtare në Hagë së fundi refuzoi kërkesën e mbrojtjes së z. Hashim Thaçi që po mbahet peng në Njësinë e Paraburgimit bashkë me shtatë shtetas të Kosovës, të gjithë ushtarë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, themelues dhe, pas përfundimit të luftës, bartës të posteve më të larta shtetërore, kërkesën për zëvendësim të paraburgimit me një masë tjetër. Para refuzimit të kërkesës së avokatëve të ish-presidentit dhe ish-krayministrit, z. Hashim Thaçi, po kjo gjykatë refuzoi të gjitha kërkesat e të burgosurve të tjerë, pa asnjë përjashtim, ndonëse kishin kërkuar zyrtarisht garanci nga Policia e Kosovës nëse kishte kapacitete të mjaftueshme profesionale dhe logjistike për administrim të masës tjetër në Kosovë nëse do të miratohej kërkesa e mbrojtjes sikur që kishin edhe garancitë e shteteve të treta që kishin shfaqur gatishmëri t'i pranojnë të liruarit eventuale, shtetas të Kosovës. Të gjitha nivelet e kësaj gjykate jo që nuk miratuan garancitë e Policisë së Kosovës dhe vendeve të treta por, përkundrazi, u sollën në mënyrën më shpërfillëse, fyese dhe përjashtuese ndaj Policisë së Kosovës, institucion që gëzon besueshmëri të lartë në Kosovë dhe jo vetëm në Kosovë pikërisht për shkak të profesionalizmit të dëshmuar. Për të gjithë njohësit e kësaj fushe është e qartë se kur bëhet një kërkesë për zëvendësim të masës së paraburgimit me një masë tjetër kuptohet se masa tjetër duhet të jetë më e favorshme për të burgosurin, në përputhje me të drejtat e njeriut të personave të privuar nga liria sikur edhe në përputhje me dokumentet ndërkombëtare shkaku se ato kombëtare përbuzen skajshmërisht nga kjo gjykatë që nënkupton se, pa



e paragykuar parimin e pafajësisë, të burgosurit duhet të mbahen të privuar nga liria sa më afër familjes dhe vendbanimit ku kanë jetuar. Kjo e drejtë dhe standard ndërkombëtar dhunohet brutalisht nga Gjykata Speciale, politika aktuale kosovare sikur edhe nga deputetët e Kuvendit të Kosovës që, me heshitjen apo mosveprim ndaj kësaj shkeljeje flagrante të drejtave të njeriut, po bëhen pjesë aktive e këtij dhunimi. Politikanët aktualë të Kosovës nuk mund dhe nuk duhet ta paragykojnë parimin e pafajësisë, por mund dhe duhet t'i mbrojnë institucionet e Kosovës që po shpërfillen apo turpërohen nga kjo gjykatë siç është rasti me garancitë e Policisë së Kosovës. Deputetët e Kuvendit të Kosovës, që nën masa të dhunës psikologjike

dhe shantazhimit u detyruan ta votojnë këtë gjykatë, duhet ta shtrojnë këtë çështje në një nga seancat, nëse vërtet mendojnë se Kuvendi i Kosovës është themelues i kësaj gjykate. Nuk mjaftojnë vizitat familjare që u bëjnë zyrtarë të institucioneve dhe të cilat, gjithashtu, injorohen nga kjo gjykatë për ta dëshmuar përkushtimin dhe interesimin për shtetasit e arrestuar e që po mbahen peng. Përkundrazi, këto vizita janë të dëmshme për të burgosurit sepse krijojnë një iluzion publik se ata po trajtohen mirë dhe se respektohen të drejtat e njeriut e që nuk është aspak e vërtetë. Deputetët e Kosovës duhet t'i thërrasin në interpelancë këta zyrtarë, përfitues të çastit dhe të marrin përgjigje për rezultatet konkrete që ndikojnë në

përmirësimin e kushteve dhe transferimin e të burgosurve në Kosovë, më afër familjeve, me ç'rast edhe do të ruheshin lidhjet familjare sikur edhe do të kursehej buxheti i Kosovës. Nuk ka asnjë logjikë dhe kuptim që Nasim Haradinaj, Hysni Gucati të mbahen në paraburgim në Hagë kur gjykimi i tyre ka përfunduar për një vepër për të cilën më shumë kanë përgjegjësi Zyra e Prokurorit të Specializuar që për shkaqë korruptive apo politike ka lejuar, mundësuar dhe menaxhuar rrjedhjen e dokumenteve të ndjeshme, prejardhja e të cilave është kryesisht nga Serbia. As Salih Mustafa nuk nevojë të mbahet në Hagë për faktin se gjykimi ndaj tij thuaja ka përfunduar. Në kohën kur deputetët e Kuvendit të Kosovës do të detyrohen shumë shpejt ta

votojnë një marrëveshje kriminale dhe raciste për shitje të sovranitetit të një pjese të Kosovës, përkatësisht Burgut në Pasjak të Gjilanit, ku do të vendosen 300 shtetas jodanezë të dënuar në Danimarkë, të cilët ia shtet Kosovës sepse nuk i do të jenë në Danimarkë, e të heshtësh ndaj diskriminimit që u bëhet shtetasve të Kosovës përmes mohimit të drejtës të jenë afër familjeve të tyre, nuk është vetëm përgjegjësi morale dhe njerëzore por, në radhë të parë, është përgjegjësi institucionale sepse me votën për themelimin të kësaj gjykate kanë krijuar mundësinë për shkeljen e të drejtave të njeriut. Në mes të asaj se a do të lejohet mbushja e buxhetit të Kosovës duke importuar krim dhe kriminelë nga Danimarka dhe të drejtës që shtetasit e Kosovës që mbahen peng në Njësinë e Paraburgimit në Hagë të jenë më afër familjeve të tyre, për një deputet të përgjegjshëm nuk do të duhej të kishte mëdyshje. Është mashtrim i radhës, sikur në rastin e votimit të demarkacionit, se nëse votohet marrëveshja kriminale dhe raciste me Danimarkën me të cilën do të legalizohet importimi i kriminelëve, do të jemi më afër liberalizimit të vizave shkaku se Danimarka nuk do ta përdorte veton. Shtetasve të Kosovës, të arrestuar dhe të syrgjynosur në Hagë, nuk ka kush t'ua mbrojtë të drejtat për të qenë më afër familjeve, me çfarëdo mase të shqiptuar nga arbitrariteti i burokratëve të Gjykatës Speciale dhe nga mosveprimi i KNKK nga Gjeneva dhe i ashtuquajturit Ombudsperson i Gjykatës Speciale që kanë ekskluzivitet për këtë. Viktimave duhet t'u sigurohet qasja dhe përmbushja e drejtësisë, kurse të privuarve nga liria të drejtat që u takojnë.

Kuvendi miraton Projektligjin për Zyrtarët Publikë

PRISHTINË, 7 PRILL - Deputetët e Kuvendit të Kosovës kanë miratuar të enjten në lexim të parë Projektligjin për Plotësim-Ndryshimin e Ligjit për Zyrtarët Publikë.

Me këtë projektligj synohet ndryshimi i nenit 22, që ia jep

mundësinë personelit akademik të universiteteve publike të vijojnë procedurat për marrjen e gradave akademike edhe pasi zgjedhen deputetë.

Paraprakisht deputetët kanë miratuar shmangien e afateve të parapara nga rregullorja e

Kuvendit për miratimin e këtij projektligji.

Projektligji është iniciuar nga shefja e grupit parlamentar e Lëvizjes Vetëvendosje, Mimoza Kusari-Lila, dhe është përkrahur edhe nga disa deputetë të partive opozitare.





KËSHILLI I INVESTITORËVE EVROPIANË (EIC) TË ENJTEN KA ORGANIZUAR KONFERENCË NË GJASHTËVJETORIN E HYRJES NË FUQI TË MARRËVESHJES SË STABILIZIM ASOCIIMIT (MSA)

BE-ja kërkon nga qeveria t'i përmbushë të gjitha obligimet e MSA-s

Me rastin e gjashtëvjetorit të hyrjes në fuqi të Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit (MSA), shef i Zyrës së BE-së, Tomas Szunyog, ka thënë se falë këtij mekanizimi Kosova ka zhvilluar procese shumë të rëndësishme në sektorët e drejtësisë, tregtisë, arsimit dhe punësimit. Ai ka theksuar se sa më shumë të zbatohet MSA-ja, aq më shumë do të përfitojë Kosova. Szunyog ka thënë se roli i Qeverisë së Kosovës është ta udhëheqë dhe ta sigurojë përmbushjen e të gjitha obligimeve që rrjedhin nga MSA-ja. Ndërkaq zëvendëskryeministri i Kosovës, Besnik Bislimi, ka siguruar se kanë ndërmarrë të gjitha hapat për zbatim të MSA-së duke filluar nga hartimi i ligjeve

tjetër ka të bëjë edhe me shërbimet financiare. Ideja është që ambienti i të bërit biznes në Kosovë të jetë më i favorshëm”, ka thënë ai.

Bislimi ka theksuar se dy vitet e fundit kanë qenë të vështira për shkak të pandemisë. “Tani goditja tjetër na ka ardhur nga kriza energjetike. Me gjithë këto sfida, kemi arritur ta përfundojmë vitin 2021 me shifra të mëdha të ekonomisë për 10.53 për qind, që e bën Kosovën se ka pasur rritje ekonomike dyshifrore. Për datën 5 prill kemi rritje të të hyrave buxhetore për 25.4 për qind. Ne në këta tre muaj kemi shënuar ulje të tatimeve në pronë. Këtë vit situata do të jetë dukshëm më e mirë”, ka thënë zëvendëskryeministri Bislimi.

Duke pasur parasysh rëndësinë që ka MSA-ja në rrugën drejt BE-së si dhe në zhvillimin e vendit, Grupi për Studime Juridike dhe Politike ka bërë një vlerësim të implementimit të Planit Kombëtar për Zbatim të MSA-së për vitin 2021 në tërësi. Për ta realizuar këtë vlerësim, GLPS-ja ka kërkuar informata nga të gjitha institucionet përgjegjëse në lidhje me punën e tyre duke vlerësuar se sa kanë arritur t'i përmbushin objektivat e paracaktuara. Në të njëjtën kohë ka vlerësuar afatet kohore të zbatimit dhe sa të

kujdesshëm ishin në procesin e përafërimit të akteve ligjore të Kosovës me korpusin e të drejtës së BE-së, Acquin.

Të gjeturat e monitorimit të GLPS-së për implementimin e PZKMSA-së për vitin 2021 tregojnë se nga gjithsej 245 veprime, institucionet përgjegjëse kanë arritur të përmbushin plotësisht vetëm 119 veprime, apo rreth 49 për qind të totalit të paraparë për vitin që lamë pas. Pjesët e tjera mbesin ende të papërmbushura ose në proces, rrjedhimisht janë bartur për vitin 2022.

Brenda PKZMSA-së masat ndahen në ato legislative dhe zbatuese.

Të dhënat nga vlerësimi i realizuar tregojnë se nga gjithsej 111 masa legislative, vetëm 45 për qind janë përmbushur, kurse nga 134 masa zbatuese, 51 për qind rezultojnë të plotësuara.

Nga vlerësimi i GLPS-së posaçërisht mund të nxirren përfundimet e dhëna se: Në shumë raste institucionet e Kosovës nuk kanë arritur të hartojnë në kohë, apo nuk kanë filluar që t'i hartojnë ligjet që janë parashikuar që të miratohen gjatë vitit 2021; Një numër i madh i institucioneve nuk kanë arritur që ta hartojnë legjislacionin sekondar, edhe në ato raste kur

**EPOKA
ERE** Mal QORRAJ

Prishtinë, 7 prill - Me rastin e gjashtëvjetorit të hyrjes në fuqi të Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit, shef i Zyrës së BE-së dhe përfaqësuesi special i BE-së në Kosovë, Tomas Szunyog, ka thënë se për këto gjashtë vjet, në bashkëpunim me Bashkimin Evropian, Kosova ka zhvilluar procese shumë të rëndësishme në sektorët e drejtësisë, tregtisë, arsimit dhe punësimit. “Sikur sot, gjashtë vjet më parë, hyri në fuqi Marrëveshja e Stabilizim Asociimit, si marrëdhënia e parë kontraktuale në mes të BE-së dhe Kosovës, duke e përcaktuar kështu perspektivën e saj evropiane. Përgjatë gjashtë vjetëve të fundit, në bashkëpunim me Bashkimin Evropian, Kosova ka zhvilluar procese shumë të rëndësishme në sektorët e drejtësisë, tregtisë,

arsimit dhe punësimit”, ka thënë ai, duke shtuar se dialogu politik dhe marrëdhëniet e fqinjësisë së mirë janë pjesë e rëndësishme e kësaj pune. “MSA-ja është mjet jetësor për zbatimin e qëllimeve të Agjendës së Gjellbër duke kaluar në prodhimin e qëndrueshëm të energjisë dhe duke siguruar mbrojtjen e mjedisit. Marrëveshja u nënshkrua për një periudhë fillestare dhjetëvjeçare, me mundësi të zgjatjes. Në katër vjetët e ardhshëm duhet të punohet për arritjen e progresit të qenësishëm. Sa më shumë të zbatohet marrëveshja, aq më shumë do të përfitojë Kosova”, është shprehur Szunyog.

Ai ka theksuar se në fund të fundit, është roli i Qeverisë së Kosovës që të udhëheqë dhe ta sigurojë përmbushjen e të gjitha obligimeve që rrjedhin nga Marrëveshja e Stabilizim Asociimit, me mbështetjen dhe

në bashkëpunim me Kuvendin, shoqërinë civile dhe sektorin privat. “BE-ja është partneri juaj dhe ne jemi të gatshëm të ndihmojmë. Së bashku mund ta sjellim ndryshimin”, ka thënë shef i Zyrës së BE-së në Kosovë, Tomas Szunyog.

Zëvendëskryeministri i Kosovës, Besnik Bislimi, ka thënë se kanë ndërmarrë të gjitha hapat për zbatim të MSA-së duke filluar nga hartimi i ligjeve. Krejt këto reforma ai ka thënë se si synim kanë që ambienti i të bërit biznes në Kosovë të jetë më i favorshëm. “Unë koordinoj agjendën e integriteteve, mirëpo puna e madhe është bërë në ministri të linjës dhe një numër të madh të ligjeve veç i kemi përfunduar. Janë edhe 30 ligje nëpër komisione. Boshiti i marrëveshjes sillet rreth ekonomisë dhe sundimit të ligjit. Këto dy marrëveshje kanë marrë përsipër shumë obligime rritjen e konkurrueshmërisë. Një fushë

Kurti merr pjesë në Forumin Ekonomik Delphi, takon personalitete të ndryshme

Delphi, 7 prill (ER) - Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, i shoqëruar edhe nga zëvendëskryeministrja, njëherësh ministre e Punëve të Jashtme dhe e Diasporës, Donika Gërvalla, në margjinat e Forumit Ekonomik Delphi, pati takim me kryetarin e Presidencës së Bosnjë Hercegovinës, Shefik Xhaferović, me të cilin diskutuan mbi raportet ndërmjet dy vendeve dhe mundësitë e forcimit dhe përparimit të bashkëpunimit përkundër pengesave politike. Në takim u diskutua për situatën

politike dhe të sigurisë së rajonit, pas invazionit dhe agresionit rus në Ukrainë, të cilën të dy e dënuan ashpër.

Kryeministri Kurti tha se duhet të vazhdojmë të solidarizohemi dhe ta mbështesim luftën nacionalçlirimtare të popullit ukrainas dhe të jemi syhapur karshi lidhjeve të gjera dhe të thella të Federatës Ruse dhe Serbisë.

Takimin e radhës në kuadër të Forumit Ekonomik të Delphi, kryeministri Kurti e zhvilloi me

kryeshëfin ekzekutiv të Forumit Ndërkombëtar të Fondeve Sovrane të Pasurisë (IFSWF), Duncan Bonfield. "Qeverisja e mirë dhe transparenca janë komponentë themelore për mirëfunksionimin e ndërmarrjeve publike", u shpreh kryeministri Kurti.

Ai e njoftoi Duncanin për veprimet e qeverisë në reformimin dhe ringjalljen e ndërmarrjeve publike.

Kurti e Duncan diskutuan edhe për Fondin Sovran të Republikës

së Kosovës, koncept dokumenti i të cilit tashmë është miratuar. "Më konkretisht, se si ky fond mund t'i mobilizojë resurset, orientojë investimet dhe përmirësojë qeverisjen korporative dhe se si IFSWF mund të na ndihmojë me dijen dhe përvojën e tyre në arritjen e këtyre synimeve", ka njoftuar zyra për informim e kryeministrit Kurti.

Gjatë qëndrimit të tij atje, Kurti do të zhvillojë takime zyrtare me përfaqësues të ndryshëm.

Forum i parë Ekonomik Delphi u iniciua nën kujdesin e presidentit të Republikës së Greqisë, Prokopis Pavlopoulos, më 25 shkurt 2016 në Qendrën Kulturore Evropiane në Delphi. Që atëherë forumi konsiderohet si një ngjarje politike, sociale dhe financiare brenda rajonit më të gjerë me tërheqje ndërkombëtare. Pjesëmarrës nga 32 vende dhe më shumë se 200 përfaqësues të medieve zakonisht bashkohen në takime për çdo vit.



Në 24 orët e fundit janë dhënë 151 doza të vaksinës kundër Covidit

PRISHTINË, 7 PRILL (ER) - Ministria e Shëndetësisë ka njoftuar se të enjten, pas 812 testeve, 27 qytetarë kanë rezultuar pozitivë me virusin Covid-19.

Gjatë 24 orëve të fundit nuk është shënuar asnjë rast i vdekjes.

Të enjten janë shëruar edhe 15

qytetarë, ndërsa numri i përgjithshëm i të shëruarve është 223 968. Në total numri i rasteve aktive me Covid është 550.

Në 24 orët e fundit janë dhënë 151 doza të vaksinës kundër Covid-19.

Prej fillimit të vaksinimit në të

gjitha qytetet e Kosovës janë dhënë 1 823 272 doza të vaksinës.

Deri më sot 820 906 qytetarë janë vaksinuar me dozën e dytë. Deri më sot janë dhënë 100 437 doza përforcuese dhe doza të treta të vaksinës kundër Covid-19.



ligjet ka vite që ishin miratuar dhe janë në fuqi; Në të njëjtën kohë, vlerësimi tregon që institucionet përgjegjëse janë të prira të dështojnë të realizojnë ato objektiva, arritja e të cilave varet nga puna ndërinstitucionale dhe planifikimi afatgjatë; Disa masa (p. sh: Rregullorja e Re e Kuvendit, Ligji për Arsimin e Lartë, Projektligji për Edukimin në Fëmijërinë e Hershme 0-6 vjeç etj.) barten nga viti në vit dhe

karakterizohen me vonesa të shpeshta dhe stagnime gjatë procedurave; Disa institucione mospërbushjen e masave të parapara ia kanë atribuuar situatës epidemiologjike në Kosovë; Në disa raste projektligjet janë kthyer në rishikim për shkak të mosharmonizimit me Aquis, sikurse është rasti me projektligjin për Prokurim Publik; Në fushën e Administratës Publike mbeten një sërë projektligjesh të pamiratuara,

por shumë të rëndësishme dhe prioritare, siç janë Projektligji për Paga, Projektligji për Zyrarët Publikë dhe Projektligji për Valën e Dytë të Racionalizimit të Agjencive të Pavarura.

Marrë parasysh këto rezultate, GLPS-ja kërkon nga Qeveria e Kosovës që ta përmirësojë kontrollin e performancës së institucioneve nën menaxhimin e saj dhe institucioneve të tjera përgjegjëse, duke kërkuar nga këto

të fundit që jo vetëm të raportojnë, por edhe t'i plotësojnë objektivat në kuadër të këtij procesi.

Po sipas GLPS-së, duhet filluar një proces të ri të prioritizimit të objektivave që duhen arritur. GLPS-ja ka theksuar se suksesi i institucioneve në fund matet nga aftësia e tyre për të përmbushur objektiva më të rëndësishme, siç është pakoja e ligjeve për reformë të administratës publike dhe Ligji për Arsimin e Lartë.

Këto ditë edhe kabineti qeveritar ka diskutuar për Zbatimin e Programit Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizimit Asociimit (PKZMSA) 2021-2025. "Programi në vitin 2021 është zbatuar në nivel prej 51.43-përqindësh; 126 nga 245 masat e planifikuara janë zbatuar, ndërsa 48.57 për qind të tyre nuk janë zbatuar ose 119 masa nuk janë zbatuar", ka njoftuar Qeveria e Kosovës.

Përkujtohen dëshmorët Xhevat dhe Bedri Demaku dhe Imer Shala

DRENAS, 7 PRILL (ER) - Me rastin e shënimit të 23-vjetorit të rënies së dëshmorëve Xhevat Demaku, Bedri Demaku dhe Imer Shala, kryetari i komunës së Drenasit, Ramiz Lladrovci, me kabinetin e tij, bashkëluftëtarë dhe veteranë të UÇK-së dhe qytetarë, kanë bërë homazhe pranë vendit ku prehen dëshmorët në

varrezat e dëshmorëve në fshatin Abri. Kryetari Lladrovci ka theksuar se nderimi i dëshmorëve të kombit është nderim i shtetit të Kosovës. "Përvjetorët e dëshmorëve janë ditëlindje e shtetit të Kosovës sepse pa sakrificën e tyre ky vend që po e gëzojmë lirinë nuk do ta kishte epitetin 'shtet' sepse

nuk do të ishte i pavarur, por që vepra heroike e dëshmorëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës e realizoi këtë epitet të vendit tonë, shtetin e Kosovës, pra dëshmorët janë simbol i pazëvendësueshëm i shtetësisë së Kosovës, vulë dhe ADN e kësaj shtetësie", ka thënë Lladrovci.



Hyseni merr mbështetje nga Osmani për t'i shtyrë përpara projektet zhvillimore për Gjilanin



GJILAN, 7 PRILL (ER) - Kryetari i komunës së Gjilanit, Alban Hyseni, së bashku me kryesuesin Arianit Sadiku dhe bashkëpunëtorët, ka pritur në takim presidenten Vjosa Osmani. Pasi e ka falënderuar presidenten Osmani për vizitën, kryetari Hyseni ka thënë se ndihet i nderuar që Gjilani është komuna e parë që është zgjedhur për këtë vizitë. "Unë e kam njoftuar presidenten për disa prej problemeve kryesore, prioritetet tona dhe disa prej projekteve që i kemi iniciuar deri tani. Ne kemi marrë mbështetje për të na ndihmuar dhe për t'i shtyrë përpara projektet e përbashkëta", ka thënë kryetari Alban Hyseni në një prononcim para gazetarëve. Presidentja Vjosa Osmani e ka falënderuar kryetarin Hyseni për

pritjen, derisa ka thënë tha se vizitën e ka filluar te kryetari më i ri në moshë, për t'i inkurajuar të rinjtë që të angazhohen në politikë, në vendimmarrje. "Jemi jashtëzakonisht të inkurajuar nga projektet që komuna e Gjilanit ka paraparë. Shumë prej tyre kanë avancuar dhe shumë prej tyre kanë nevojë edhe për mbështetje nga niveli qendror. Si presidente kam synim që projektet që propozohen nga komunat e Kosovës t'i prezantojmë para partnerëve tanë ndërkombëtarë në vendet që unë i vizitoj, para liderëve të shteteve të cilët janë të interesuar që të investojnë në Kosovë dhe në veçanti t'i ndihmojnë projektet të cilat e ndryshojnë jetën e qytetarëve tanë për së miri", ka thënë Osmani.

Ambulanca mjekësore në Llaushë do të rihapet shpejt

SKENDERAJ, 7 PRILL (ER) - Komuna e Skenderajt ka bërë me dije se së shpejti do të kthehet në funksion ambulanca mjekësore në Llaushë. Ky njoftim i komunës ka ardhur pasi të mërkurën në rrjetet sociale ka qarkulluar një video e vjetër e cila paraqet gjendjen e ambulancës mjekësore në fshatin Llaushë. "Kjo AMF është e mbyllur që nga korriku i vitit 2020 nga qeverisja e kaluar. Si qeverisje komunale jemi në fazën finale të përcaktimit të stafit mjekësor dhe shpejt kjo AMF do të kthehet në shërbim të qytetarëve të Llaushës. Gjithashtu, edhe AMF në fshatin Qubrel është mbyllur në fillim të vitit 2020, të cilën do të përpiqemi ta kthejmë në funksion sa më parë", ka njoftuar komuna e Skenderajt.

Para disa muajve edhe Qendra e Mjekësisë Familjare në Likoc ka qenë e mbyllur, por tashmë ofron

shërbimet e nevojshme për qytetarët e kësaj zone. "Në QKMF në Skenderaj kemi vënë në funksion pajisje të reja në vlerë mbi 120 000 euro, kurse jemi në proces të kthimit në funksion të shërbimeve sa më të mira për qytetarët. Edhe në Runik e kemi angazhuar mjekun e ri i cili punon me orar të plotë. Me marrjen e mandatit si qeverisje komunale, pavarësisht se buxhetin e kemi pasur të miratuar, i kemi dhënë prioritet shëndetësisë duke rritur numrin e mjekëve nga 28 sa kanë qenë, në 32, si dhe kemi kthyer nga pensioni edhe pesë mjekë të tjerë familjarë me qëllim të ofrimit të shërbimeve shëndetësore për qytetarët. Si qeverisje lokale do të jemi gjithmonë në shërbim të qytetarëve për aq sa dimë e sa mundemi", ka njoftuar komuna e Skenderajt.



Komuniteti rom, ashkali dhe egjiptian lirohen nga pagesa e shërbimeve të gjendjes civile



PODUJEVË, 7 PRILL (ER) - Komuna e Podujevës ka bërë me dije se komuniteti, rom, ashkali dhe egjiptian lirohen nga pagesa e shërbimeve të gjendjes civile përgjatë muajit prill 2022. "Bazuar në vendimin e Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL),

Drejtoria e Administratës në komunën e Podujevës njofton qytetarët e komunitetit rom, ashkali dhe egjiptian për lansimin e fushatës për regjistrim falas në librat e regjistrimit civil", ka njoftuar komuna e Podujevës. Sipas këtij njoftimi, kjo fushatë zgjatë deri

në fund të muajit prill 2022, ndërsa ka për qëllim promovimin e të drejtave të komuniteteve, sidomos të regjistrimit të faktit të lindjes dhe të regjistrimit të mëvonshme, si segment i rëndësishëm i të drejtave të njeriut.

Zhgënjim me procesin e KPK-së për kryeprokuror të shtetit

EPOKA
ERE **Albulena S. MAVRAJ**

PRISHTINË, 7 PRILL - Bashkimi Evropian ka shprehur zhgënjim me procedurën e përzgjedhjes së kandidatit për kryeprokuror të shtetit.

Shefi i Zyrës së BE-së në Prishtinë, Tomas Szunyog, ka pohuar se Këshilli Prokurorial i Kosovës (KPK) nuk i ka respektuar rregullat që ky proces të ishte fer dhe transparent.

Më 6 prill KPK-ja nominoi Blerim Isufajn për postin e kryeprokurorit të shtetit. Emri i tij duhet të dekretohet nga presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani. "Pavarësisht prej thirrjeve të vazhdueshme për të siguruar një përzgjedhje fer, transparente dhe të bazuar në merita, të kryeprokurorit të shtetit, Këshilli Prokurorial i Kosovës e përmbylli procesin duke mos i respektuar këto parime. I befusuar dhe i zhgënjyer me veprimet e KPK-së", ka reaguar Szunyog përmes një postimi në "Twitter".

Edhe ambasadori gjerman në Prishtinë, Jörn Rohde, po ashtu shprehu zhgënjimin për vendimin e KPK-së, duke thënë se kjo nuk është mënyra e "duhur për të ecur përpara". Organizatat që merren me monitorimin e sistemit të drejtësisë kanë reaguar

pas votimit unanim nga KPK-ja për Isufajn.

Pas këtyre ka reaguar edhe ambasadori i Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Kosovë, Jeff Hovenier, duke thënë se fakti që anëtarët e KPK-së nuk i kanë marrë parasysh ankesat legjitime dhe rekomandimet e panelit shqyrtues bie ndesh me atë standard.

"Përfaqësuesit ndërkombëtarë, përfshirë anëtarët të Ambasadës së ShBA-së, u ftuan të marrin pjesë në procedurat e Këshillit Prokurorial të Kosovës (KPK) më 6 prill për ta zgjedhur kryeprokurorin e ardhshëm të shtetit. Prania jonë si vëzhgues nuk duhet të konsiderohet si miratim i procesit apo procedimit. Në disa raste Shtetet e Bashkuara kanë shprehur pritshmëri për procesin e përzgjedhjes së kryeprokurorit të ardhshëm të shtetit, të cilat ne besojmë se i ndajmë me qytetarët e Kosovës që: të jetë i drejtë, objektiv, transparent dhe i bazuar në merita. Fakti që anëtarët e KPK-së nuk i kanë marrë parasysh ankesat legjitime dhe rekomandimet e panelit shqyrtues, bie ndesh me atë standard", ka theksuar ambasadori Hovenier, duke theksuar se Shtetet e Bashkuara nuk kishin një kandidat të preferuar dhe as nuk gjykonin



kualifikimet e kandidatëve individualë. "Jemi të shqetësuar se mënyra se si KPK i ka zhvilluar këto procedura ka dëmtuar besimin e publikut kosovar dhe besimin tonë në KPK si institucion publik", ka pohuar Hovenier. Nëpërmjet një reagimi të përbashkët, Instituti i Kosovës për Drejtësi, Grupi për Studime Juridike dhe Politike dhe Lëvizja FOL thanë se që prej mesit të marsit kanë publikuar një raport për shkelje gjatë procesit vlerësues

të kandidatëve për kryeprokuror. Këto organizata kanë theksuar se paneli vlerësues i kishte vlerësuar kandidatët në mënyrë të pabazuar "duke cenuar meritokracinë e procesit". "KPK-ja ka dështuar që gjatë procesit të intervistimit të kandidatëve për kryeprokuror të shtetit të sqarojë dhe sigurojë se kandidati për kryeprokuror të shtetit ka integritet të pakontestuar dhe që i përshatet pozitës së kryeprokurorit të shtetit. Si

rrjedhojë, koalicioni [i organizatave joqeveritare] rekomandonte që i tërë procesi i përzgjedhjes dhe emërimit të kryeprokurorit të ri të shtetit të anulohet dhe të përsëritet, ashtu që të evitoheshin shkeljet procedurale dhe defektet e evidentuara", thuhet në reagimin e këtyre organizatave.

Kryeprokurori i shtetit është pozitë e rëndësishme në sistemin e drejtësisë së Kosovës. Kjo pozitë ka një mandat prej shtatë vjetësh.

24 % e vdekjeve në botë, të lidhura me shkaqet mjedisore

Mbi 90 % e njerëzve thithin ajër të papastër që vjen nga djegia e lëndëve djegëse si thëngjilli, nafta, lëndë djegëse të kemikaleve e të tjera, ndërsa 24 % e vdekjeve në botë janë të lidhura me shkaqet mjedisore. Kështu është bërë me dije të enjten me rastin e Ditës Botërore të Shëndetit

EPOKA
ERE **Faton DËRMAKU**

PRISHTINË, 7 PRILL - Me moton "Planeti ynë - shëndeti ynë", të enjten në Institutin Kombëtar të Shëndetësisë Publike të Kosovës është shënuar 7 Prilli, Dita Botërore e Shëndetit, e cila shënohet në gjithë botën që nga viti 1950.

Shënimi i kësaj dite ka për qëllim vetëdijësimin për një prioritet shëndetësor të përzgjedhur nga Organizata Botërore e Shëndetësisë që do ta përqendrojë vëmendjen në veprimet urgjente të nevojshme për t'i mbajtur njerëzit dhe planetin të shëndetshëm.

Zëvendësministri i Shëndetësisë, Arsim Berisha, ka thënë se e drejta e secilit njeri për shëndet është një e drejtë themelore dhe universale. Por, kjo e drejtë, ka theksuar ai, cenohet nga shkaqet e faktorë të ndryshëm që ndikojnë mbi shëndetin, përfshirë faktorët mjedisore si ndryshimet e klimës, ajri i ndotur, djegia e lëndëve djegëse, furnizimi i dobët me ujë kualitativ, qasja joadekuate në rrjetet e kanalizimit, derdhja e

ujërave të zeza, dietat jo të shëndetshme dhe përdorimi i alkoolit dhe ushqimit jo të shëndetshëm dhe faktorë të tjerë. Ai ka thënë se reduktimi i faktorëve të rrezikut bëhet përmes një ndërveprimi të gjithë aktorëve duke vepruar si institucione, individë, sektorë qeveritarë e joqeveritarë dhe me rritje të investimeve në shëndetësi.

Berisha ka thënë se në këtë drejtim Ministria e Shëndetësisë ka miratuar planin e veprimit për promovim dhe edukim shëndetësor (2021) që synon promovimin e mënyrës së shëndetshme të jetesës dhe krijimin e shprehive, të cilat kanë ndikim në ruajtjen dhe përmirësimin e shëndetit të qytetarëve.

Linda Qavdarbasha, zëvendësministre e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, ka thënë se 24 % e vdekjeve që shkaktohen në botë janë të lidhura me shkaqet mjedisore prandaj, ka theksuar ajo, të gjithë duhet të bëjnë më shumë për ta përmirësuar shëndetin dhe faktorët që ndikojnë në të.

Drejtor i IKShPK-së, Naser



Ramadani, ka thënë se, sipas OBSH-së, mbi 90 për qind e njerëzve thithin ajër të papastër që vjen nga djegia e lëndëve djegëse si thëngjilli, nafta, lëndë djegëse të kemikaleve të tjera. Ai ka theksuar se përderisa pandemia Covid-19 fuqizoi dijen e shkencës, ajo gjithashtu theksoi pabarazitë në botën tonë dhe ka nënvizuar urgjencën e krijimit të shoqërive me mirëqenie të qëndrueshme të përkushtuara për arritjen e barazisë në shëndet

tani dhe për brezat e ardhshëm pa shkelur kufijtë ekologjikë. Oleksander Martynenko, shef i Zyrës së OBSH-së në Kosovë, ka thënë se këtë Ditë Botërore të Shëndetit, OBSH-ja po bën thirrje urgjente për veprime të përshpejtuara nga drejtuesit dhe të gjithë njerëzit për të ruajtur dhe mbrojtur shëndetin dhe për ta zbutur krizën klimatike. "Në kohën e konfliktit të shtuar dhe brishtësisë që ne kemi përvojë nga Evropë, po e përjetojmë më

qartë se kurrë se gjithçka është e ndërlikuar: problemet, zgjidhjet dhe ne, njerëzit që i shkaktojnë ato, që vuajnë prej tyre dhe që mund të bëjmë një ndryshim pozitiv", ka thënë ai.

Edhe nga shënimi i Ditës Botërore të Shëndetit u është bërë thirrje qytetarëve të pavaksinuar që të vaksinohen me vaksinën kundër Covid-19 dhe të mos e ulin kujdesin për shkak se pandemia nuk ka përfunduar ende.

Inflacioni mund të rritet edhe më shumë



Prishtinë, 7 prill - Është vështirë që të ndërmerret ndonjë masë për parandalimin e rritjes së inflacionit në Kosovë, pasi një gjë e tillë do të kishte efekte negative në rritjen e ekonomisë së vendit, tha të mërkurën guvernatori i Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës, Fehmi Mehmeti. Ai i bëri këto komente gjatë një raportimi para Komisionit Parlamentar për Buxhet, Punë dhe Transfere. Sipas tij, agresioni rus në Ukrainë, që ka nisur më 24 shkurt, ka trazuar ekonominë globale, me theks të veçantë atë të Evropës dhe kështu ka pasur ndikim jodirekt edhe në Kosovë.

Evropa gati 40 për qind të furnizimeve me gaz i merr nga Rusia.

Rusia dhe Ukraina së bashku përbëjnë afro 30 për qind të eksporteve globale të grurit.

Tregjet, paraprakisht, i ka lëkundur edhe pandemia e koronavirusit.

Rritja e çmimeve të konsumit në dy muajt e parë të këtij viti pothuajse e ka dyfishuar inflacionin në Kosovë në krahasim me mesataren vjetore të vitit 2021.

Sipas Indeksit të Harmonizuar

të Çmimeve të Konsumit, që del nga Agjencia e Statistikave të Kosovës, inflacioni vjetor gjatë vitit 2021 ka qenë mesatarisht 3.4 për qind. Ndërkaq, në janar të këtij viti inflacioni mujor ka qenë 7.1 për qind dhe në muajin shkurt 7.5 për qind. Mehmeti i konfirmoi të dhënat e Agjencisë së Statistikave të Kosovës.

Ai ka thënë se në disa takime të mbajtura me Bankën Qendrore Evropiane nuk është marrë ndonjë masë që do ta parandalonte rritjen e inflacionit me qëllim që të mos pengohet, sipas tij, rritja ekonomike në vend. "Prandaj, edhe ne, si Bankë Qendrore, por po mendoj edhe Qeveria [e Kosovës], në këtë kontekst... nëse shkojmë dhe marrim masa me qëllim që ta ndalim inflacionin - edhe pse është shumë e vështirë, sepse është inflacion i importuar - atëherë do ta ndikojmë ose do të kemi efekt negativ në rritjen ekonomike", ka thënë Mehmeti. Ai sqaroi se inflacioni është i importuar për shkak se Kosova varet nga importimi i produkteve nga vendet evropiane.

Kosova, prej vitesh, përballet

me deficit të lartë tregtar. Sipas të dhënave të Agjencisë së Statistikave të Kosovës, importi i mallrave në janar të këtij viti ka kapur vlerën e 338.1 milionë eurove, ndërsa eksporti ka qenë në vlerë prej 64.2 milionë eurosh.

Sadiku: Kosova importon edhe çmimet e larta

Profesori i ekonomisë në Kosovë, Muhamet Sadiku, thotë për "Radion Evropa e Lirë" se, tash për tash, burimi i çrregullimit të tregut botëror - lufta në Ukrainë - nuk jep shenja të përmirësimit. Sipas tij, "avaria ekonomike në tregun botëror do të vazhdojë". Sadiku thotë se çmimet janë rritur në mënyrë të konsiderueshme në të gjithë Eurozonën, pjesë e së cilës është edhe Kosova. Ai thotë se Kosova, me importin nga jashtë, importon edhe çmimet e larta. "Kjo do të thotë që edhe ne gjithnjë e më tepër do të jemi të prekur në muajt në vazhdim. Prandaj, unë nuk pres ndonjë qetësim të çmimeve, edhe përkundër masave që Qeveria [e Kosovës] mundohet t'i marrë. Por, Qeveria e Kosovës

nuk i ka kapacitetet e duhura që të përballet me trendet që vijnë nga tregu botëror. Po që se vazhdohet me këtë ritëm të çrregullimeve, atëherë duhet pritur që niveli i inflacionit në Kosovë të arrijë deri në 10 për qind", ka thënë Sadiku.

Rënie e rritjes ekonomike

Berim Ramosaj, profesor i Ekonomisë në Universitetin e Prishtinës, thotë se rritja e çmimeve dhe e inflacionit ndikon edhe në parashikimet për rritje ekonomike. "Ecuria e rritjes ekonomike në Kosovë, ashtu siç ka qenë e planifikuar dhe siç është parë në këta muajt e fundit, ka qenë relativisht e lartë. Do të thotë, ka qenë mbi 7 për qind. Mirëpo, unë mendoj se me këtë rritje të çmimeve në njërin anë dhe rritjen e inflacionit në anën tjetër, normat e rritjes ekonomike të Kosovës kanë rënë një deri në dy për qind më poshtë", ka theksuar Ramosaj.

Projeksionet e Bankës Qendrore në Kosovë, të publikuara më 21 mars, kanë treguar se ekonomia e Kosovës, si pasojë e luftës në Ukrainë, do

të pësojë ngadalësim të aktivitetit. Sipas tyre, rritja ekonomike do të ngadalësohet në rreth 3.3 për qind këtë vit, nga 10.5 për qind sa ka qenë në vitin 2021.

Pritjet nga ekzekutivi dhe pakënaqësitë e mundshme sociale

Ritja e çmimeve dhe e inflacionit, kujton Sadiku, ka shkaktuar protesta dhe greva në vendet e tjera të rajonit sikurse në Shqipëri. Pakënaqësitë e ngjashme, sipas tij, janë evidente edhe në Kosovë, ku pagat nuk kanë lëvizur dhe Ligji për Pagat, që parasheh rritje të tyre, nuk është miratuar ende. Disa sindikata të punëtorëve kanë paralajmëruar tashmë protesta dhe greva, në rast se Projektligji i Pagave nuk miratohet shpejt. "Nëse ne vazhdojmë me këtë nivel të ulët të të ardhurave dhe me indeks në rritje të inflacionit, atëherë është e natyrshme që do të kemi reagime sociale të popullatës, sepse askush nuk do të arrijë të përballet me rritjen e tillë të çmimeve", është shprehur Sadiku.



Aliu: Rruga Prishtinë - Podujevë pritet të përfundojë brenda dy muajve

PRISHTINË, 7 PRILL - Ministri i Infrastrukturës, Liburn Aliu, ka bërë me dije të enjten se rruga magjistrale Prishtinë - Podujevë pritet të përfundojë brenda dy muajve. Ai ka theksuar se kjo

rrugë nuk është projektuar si duhet dhe shpronësimet nuk janë bërë si duhet. "Rruga Prishtinë - Podujevë është rrugë e torturës dhe rrugë e reziqeve. Është një anomali e

përgjithshme çka kemi parë në Ministrinë e Infrastrukturës, rrugët nuk projektohen si duhet dhe nuk kryen shpronësimet si duhet. Ka mbetur pjesa e finalizimit të rrethrotullimit dhe

eliminimit të reziqeve dhe pritet të fillojnë punimet gjatë muajit prill. Pra një deri në dy muaj është afati i realizimit të këtyre punimeve", ka thënë ministri Aliu.

ZKA-ja, KMFP-ja dhe deputetë të parlamentit suedez diskutojnë për domosdoshmërinë e rritjes së ndikimit të auditimit në përmirësimin e menaxhimit të fondeve publike



Zyra Kombëtare e Auditimit (ZKA) të mërkurën dhe të enjten ka mbajtur punëtorinë për rritjen e ndikimit të auditimit përmes zbatimit të rekomandimeve.

Përveç drejtuesve të ZKA-së në punëtori kanë marrë pjesë deputetë të Kuvendit të Kosovës njëherësh anëtarë të Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave Publike (KMFP). Në kuadër të kësaj punëtorie është zhvilluar edhe një takim virtual me përfaqësuesit e Institucionit Suprem të Auditimit të Suedisë dhe deputetë të parlamentit suedez.

Në ditën e parë të kësaj punëtorie janë zhvilluar diskutimet për dy çështje thelbësore për Zyrën Kombëtare të Auditimit, siç janë zbatimi i rekomandimeve të auditimit dhe ndryshimi i Ligjit për Auditorin e Përgjithshëm. Punëtorja ka vazhduar edhe ditën e enjte, ku është diskutuar për raportin vjetor të performancës dhe strategjinë tre vjeçare të ZKA-së.

Fillimisht Auditorja e

Përgjithshme, Vlora Spanca, ka falënderuar anëtarët e Komisionit për bashkëpunimin dhe mbështetjen e vazhdueshme dhënë ZKA-së në përmbushjen e mandatit kushtetues dhe ligjor, duke thënë se puna e përbashkët ka për qëllim përmirësimin e menaxhimit të fondeve publike.

Spanca ka theksuar se përkundër këtij angazhimi, zbatimi i rekomandimeve të auditimit ende nuk është në nivelin e kënaqshëm. “Në baza vjetore, ZKA-ja publikon më shumë se 130 raporte të auditimit si dhe jep rreth 1 000 rekomandime për auditimet e rregullsisë dhe të performancës. Për të rritur ndikimin në përmirësimin e menaxhimit të financave publike, rekomandimet e auditimit duhet të zbatohen nga organizatat buxhetore e që fatkeqësisht përkundër punës tonë dhe angazhimit të KMFP-së niveli i zbatimit të rekomandimeve nuk është në nivelin e duhur. Edhe pse ka një rritje të lehtë të nivelit të zbatimit të rekomandimeve të

dhëna për vitin 2020 në 45% krahasuar me vitin 2019 që ishte 40% prap se prap niveli i përgjithshëm mbetet i ulët”, ka deklaruar Spanca.

Për të rritur ndikimin e punës, përkatesisht zbatimin e rekomandimeve të auditimit znj. Spanca, ka thënë se kërkohet përkushtimi i krerëve të institucioneve publike që të ndërmarrin masa konkrete dhe të kërkojnë llogari nga vartësit e tyre. Ndërsa, ka theksuar se është shqetësuese mos prezenca e ministrave në mbledhjet e KMFP-së kur shqyrtohen raportet e auditimit, për shkak se kjo tregon përkushtimin e pamjaftueshëm të atyre që janë të ngarkuar me llogaridhënie në zbatimin e rekomandimeve. Nëse raportet e auditimit nuk shqyrtohen dhe mbesin në sirtarë edhe puna dhe angazhimi i auditorëve mbetet e pa materializuar. Znj. Spanca ka mirëpritur iniciativën e KMFP-së për të rritur ndikimin e punës së ZKA-së përmes vizitave në teren tek organizatat buxhetore.

Tutje Auditorja e Përgjithshme ka treguar se për të qenë në

pajtueshmëri edhe me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit edhe me praktikën e BE-së si dhe për të kryer më shumë auditime në fushën e pajtueshmërisë me ligjet dhe rregulloret në fuqi, si dhe auditime të performancës për të vlerësuar efikasitetin efektivitetin dhe ekonomin e aktiviteteve qeveritare, ndryshimi i Ligjit për AP është më se i domosdoshëm.

Sa i përket nevojës për ndryshimin e Ligjit të Auditorit të Përgjithshëm dhe ZKA-së Auditorja e Përgjithshme ka bërë me dije se është përgatitur koncepti dokumenti si dhe ka e njoftuar KMFP-në që SIGMA ka shprehur gatishmërinë që ta ndihmojë ZKA-në në këtë proces.

Nga ana tjetër, Kryetarja e Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave Publike (KMFP), Hykmete Bajrami, ka folur për punën e Komisionit si dhe për rëndësinë e zbatimit të rekomandimeve të auditimit. Znj. Bajrami ka mirëpritur mbajtjen e kësaj punëtorie si një mundësi e mirë për të diskutuar

për zbatimin e rekomandimeve si dhe ka falënderuar Zyrën Kombëtare të Auditimit për bashkëpunimin e vazhdueshëm me KMFP-në. Kryetarja e KMFP-së ka mirëpritur iniciativën e ndryshimit të Ligjit për Auditorin e Përgjithshëm dhe ZKA-në. Tutje znj. Bajrami ka vlerësuar punën e ZKA-së si dhe ka shprehur përkushtimin e Komisionit për rritjen e ndikimit të punës së tyre.

Deputetja suedeze Mia Sydow Mölleby dhe Dag Levin Sparr, Këshilltar i Lartë në Zyrën Kombëtare të Auditimit të Suedisë (ZKAS) kanë prezantuar praktikën e Parlamentit Suedez dhe ZKAS-së në shqyrtimin e raporteve të auditimit dhe bashkëpunimit në mes të dyja institucioneve për të siguruar menaxhimin e mirë të fondeve publike dhe mbajtur përgjegjësi krerët e organizatave buxhetore. Deputetët e Kuvendit të Kosovës dhe ata të parlamentit suedezë kanë ndarë përvojat dhe praktikën e tyre me qëllim të rritjes së ndikimit të punës së tyre në përmirësimin e menaxhimit të financave publike.

EURO GLASS
SAINT-DONAIN SEKURIT PILKINGTON
Enveri
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



QENDRA SPORTIVE
'BUJOËSIA'
TEL: 045/82 82 82

Prishtina dhe Drita fitojnë gjysmëfinalet e para

Prishtina e fitoi ndeshjen e parë ndaj Llapit në gjysmëfinale, por finalisti do të vendoset në ndeshjen kthyesë më 13 prill. Drita është me një këmbë në finalen e madhe, pasi fitoi me rezultat 3-0 në ndeshjen e parë kundër Ramiz Sadikut

EPOKA E RE Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 7 PRILL - FC Prishtina dhe Drita kanë shënuar fitore në ndeshjet e para të gjysmëfinales së Kupës së Kosovës në futboll ndaj Llapit, përkatësisht Ramiz Sadikut. Kryeqytetasit e mposhtën skuadrën nga Podujeva në stadiumin "Fadil Vokrri" me rezultat 2-1.

Trajneri i Prishtinës, Abdulah Ibraković, ka thënë pas ndeshjes se ekipi ka funksionuar mirë dhe se është arritur një fitore shumë e rëndësishme. "Ekipi funksionoi mirë dhe arritëm ta marrim rezultatin e duhur edhe pse luajtëm me një lojtar më pak. Qëllimi i Prishtinës është të marrë fitore në çdo ndeshje. I përgëzoj futbollistët për lojën e tyre", ka thënë Ibraković.

Në minutën e 36 Gledi Mici me golin e shënuar nga penalltia e kaloi skuadrën vendase në epërsi. Llapi e barazoi rezultatin nga penalltia (1-1). Arbnor Ramadani ishte i pagabueshëm përballë portierit "bardhekaltër". Gjashtë minuta para fundit të ndeshjes, Endrit Krasniqi realizoi për 2-1. Finalisti nga kjo ndeshje do të vendoset në ndeshjen kthyesë që zhvillohet në stadiumin "Zahir



Pajaziti" në Podujevë. Pavarësisht prej humbjes, trajneri i Llapit, Tahir Batatina, është optimist se rezultati do të përmbysët në ndeshjen kthyesë. "Pranuam një gol shumë herët dhe më pas është dashur të jemi të kujdesshëm. Nuk e shfrytëzuam epërsinë numerike në pjesën e dytë, madje pranuam edhe gol. Mendoj se do ta përmbysim rezultatin në stadiumin 'Zahir Pajaziti'. Do të punojmë shumë për ndeshjen kthyesë", ka thënë Batatina.

Ndërsa skuadra e Dritës me një këmbë është në finale të Kupës, pasi e fitoi ndeshjen e parë kundër Ramiz Sadikut me rezultat 3-0. Tre golat gjilanasit i shënuar në pjesën e parë të ndeshjes. Albin Krasniqi, Almir Ajzeraj dhe Muharrem Jashari shënuar për Dritën. Në pjesën e dytë Drita nuk u mundua shumë për të shënuar ndonjë gol tjetër, kurse Ramiz Sadiku ishte e pafuqishëm për të bërë diçka më shumë. Ndeshjet kthyesë të gjysmëfinales zhvillohen më 13 prill.

SHKURT

UEFA pasqyron rizgjedhjen e Ademit në krye të FFK-së

UEFA i ka kushtuar vëmendje rizgjedhjes së presidentit Agim Ademi në krye të FFK-së për mandatin e tij të dytë. Shtëpia e futbollit evropian me një artikull të veçantë e ka pasqyruar procesin e zgjedhjes së Ademit. Aty janë veçuar edhe fjalë nga fjalimi i presidentit Ademi pasi mori besimin e shumicës absolute të delegatëve, por edhe synimi i tij për masivizimin e mëtutjeshëm të futbollit dhe zhvillimin e tij. "Këtë mandat të ri nuk e marr si privilegj, por si obligim. Megjithatë, këtë obligim nuk mund ta kryej pa ju. Unë jam një person futbollit dhe jam i lumtur që ndihem si në shtëpinë time këtu para jush", janë cituar nga UEFA fjalët e presidentit Ademi para delegatëve.

Mallorca merr vendim për Muriqin

Mallorca ka vendosur përfundimisht që mos ta blejë kartonin e sulmuesit të Kosovës, Vedat Muriqi. "Estadiodepotivo" raporton se klubi spanjoll nuk do ta shfrytëzojë mundësinë e blerjes së Muriqit për 11 milionë euro, shumë të cilën e ka vendosur Lazio. Mediumi në fjalë është i sigurt se Muriqi gjatë verës do të rikthehet në Itali pasi kartonin e tij e mban në pronësi Lazio. As klubi italian nuk duket të jetë i interesuar për ta mbajtur 27-vjeçarin. Një opsion për të ardhmen e Muriqit mbetet rikthimi në futbollin turk, aty ku e kishte arritur kulmin e karrierës sa i përket formës.

Edhe një fitore për Besa Famgas

Besa Famgas ka shënuar fitoren e radhës, përkatësisht të 25-n në 25 ndeshje të luajtura në kampionatin e Kosovës në hendboll. Në kuadër të xhiros së 25-të të Superligës A, ekipi pejan e mposhti Prishtinën në kryeqytet me rezultat 37:32. Ishte një prej derbive të kësaj xhiroje. Besa që në nismë krijoi epërsi prej disa golash, kurse pas pjesës së parë rezultati ishte 21:15 në të mirë të saj. Në pjesën e dytë epërsia e mysafirëve nuk është rrezikuar asnjëherë. Deniz Terziqi e Victor Alonso ishin më efikasit te Besa me nga shtatë gola. Pesë i kishte Nikola Prce. Te Prishtina 10 gola i shënoi Festim Mustafa, kurse nëntë i kishte Olton Beshiri. Besa Famgas është e para në tabelë me 50 pikë. Prishtina mbetet e dyta me 39 pikë.

Sonte përballen Ylli - Drita

Prishtinë, 7 prill - Xhiroja e 26 në Art Motion Superligë do të sjellë disa përballje interesante. Takimi i parë do të zhvillohet në mes të Golden Eagle Yllit dhe Dritës. Therandasit janë favoritë pasi kanë 19 fitore e gjashtë humbje, duke u renditur në vendin e parë, kurse gjilanasit janë të fundit me 25 humbje nga po aq ndeshje të zhvilluara. Të shtunën do të zhvillohet sfida e rivalëve të vjetër në mes të Trepçës dhe Bashkimit. Mitrovicasit renditen në vendin e dytë me 17 fitore e tetë humbje, kurse prizrenasit janë në vendin e shtatë me dhjetë fitore e 15 humbje. Ndeshje shumë interesante pritet ndërmjet Prizrenit 16 dhe Pejës, vendit të katërt, përkatësisht të tretë. Prizrenasit kanë 15 fitore e dhjetë humbje, ndërsa pejanët 16 fitore e nëntë humbje, andaj pritet një sfidë rivalizuese, me të dyja skuadrat që synojnë një pozitë sa më të lartë në garat e rregullta. Ndeshja e fundit zhvillohet ndërmjet Rahovecit dhe Sigal Prishtinës, skuadrës së gjashtë, përkatësisht të pestë në renditje. "Vreshtarët" kanë 11 fitore e 14 humbje, kurse prishtinasit 12 fitore e 13 humbje.

SUPERLIGA - JAVA 26

Të premten takohen:
20:30 Golden Eagle Ylli - Drita

Të shtunën takohen:
20:30 Trepça - Bashkimi

Të dielën takohen:
17:00 Prizreni 16 - Peja
20:30 Rahoveci - Sigal Prishtina

Davisi justifikohet për dështimin e lakersave: Ja çfarë na penalizoi këtë sezon

LOS ANXHELOS, 7 PRILL - Sezoni 2021-2022 në NBA për Lakersin ka qenë zhgënjyes, pasi ekipi kalifornian nuk arriti të kualifikohet për në fazën "play-off". Yjet që ka skuadra e lakersave nuk arritën ta realizojnë objektivin, ndërkohë

që në fillim të sezonit synonin titullin kampion. Skuadra asnjëherë nuk arriti të jetë kompetitive, duke zhgënjyer. Anthony Davis, duke folur për këtë sezon, ka deklaruar: "Ky ishte sezoni ku 39 ndeshje kemi pasur një pesëshe ndryshe në startin e

garës. Pra, asnjëherë nuk qenë të kompletuar, pasi problemet e ndryshme, sidomos dëmtimet, na penalizuan. E pranoj që synonim titullin, por dëmtimet na penguan ta arrinim objektivin". "Kemi humbur edhe ndeshje ku kemi qenë të gjithë në parket, por

shpesh nuk kishim shumë minuta në dispozicion. Gjithsesi, mendoj se pa problemet fizike që patëm unë dhe LeBron mund të kishim shkuar më larg. Jemi të zhgënjyer, por duhet të mendojmë për të ardhmen", është shprehur Davisi.



Presidenti i UEFA-s uron Ademin për rizgjedhjen në krye të FFK-së

PRISHTINË, 7 PRILL - Agim Ademi u rikonfirmua në krye të Federatës së Futbollit të Kosovës për një mandat të ri katërvjeçar. Ademi është uruar për rizgjedhje nga presidenti i UEFA-s, Aleksandër Çeferin. Në urimin e tij për rizgjedhjen në krye të FFK-së kreu i qeverisë së futbollit evropian ka përgëzuar Ademin për ribesimin e marrë nga delegatët e Kuvendit të FFK-së dhe për punën e bërë gjatë mandatit të parë. "Jam i lumtur t'ju përgëzoj për rizgjedhjen në krye të Federatës së Futbollit të Kosovës. Shumë punë të rëndësishme tashmë janë bërë për ta ndërtuar dhe përmirësuar infrastrukturën e futbollit - stadiumet, fushat, qendrat kombëtare të stërvitjes janë disa shembuj kyçë deri me sot. Ky progres i jashtëzakonshëm ka vendosur themelet për të ardhmen dhe ka krijuar një mjedis ku futbollit mund të ngrihet dhe të rritet për ta përmbushur potencialin



e tij të plotë. Të uroj gjithë të mirat në mandatin në vazhdim Agim dhe mezi pres të të takoj ty dhe të gjithë ekipin e Federatës së Futbollit të Kosovës, i cili vazhdon të

inkurajojë, zgjerojë dhe ofrojë mundësi të reja dhe emocionuese për futbollin në Kosovë", thuhet në urimin e presidentit të UEFA-s, Aleksandër Çeferin.

Liverpooli përgatitet ndryshe për finalen me City

LIVERPOOL, 7 PRILL - Të dielën, në orën 17:30, Manchester City dhe Liverpooli përballen në atë që fare mirë mund të konsiderohet si finalja e Premierë Ligës. Kur kanë mbetur edhe tetë ndeshje nga fundi i kampionatit, dallimi mes dy skuadrave është vetëm një pikë në favor të "qytetarëve". Të dyja ekipet së fundmi patën impenjimet në Evropë, teksa Liverpooli iu desh të udhëtonte në Portugali për përballjen ndaj Benficës. Energji të shpenzuara për djemtë e Kloppit të cilët, megjithatë, po provojnë ta bëjnë maksimumin për t'i rikuperuar energjitë. Kështu, Mohamed Salah, Trent-Alexander Arnold dhe Andy Robertson vendosën të futeshin në pishinë në orën 1:30



të natës si një mënyrë për t'i relaksuar muskujt, ndërsa sulmuesi egjiptian nuk ngurroi ta

ndante këtë moment me shokët e skuadrës edhe në rrjetet sociale.

SHKURT

Benzema: Po e shfrytëzoj çdo minutë në fushë

Sulmuesi Karim Benzema ishte protagonist me paraqitje mbresëlënëse ndaj Chelseat. Sulmuesi francez realizoi tre gola në fitoren e Real Madridit me rezultat 3-1 në "Stamford Bridge", në ndeshjen e parë çerekfinale të Ligës së Kampionëve. "Po ndihem mirë. Po e shfrytëzoj çdo minutë në fushë. Dua t'i ndihmoj si gjithmonë shokët e skuadrës. Ndihem mirë dhe po zbavitem. Po e shijoj momentin, prandaj edhe gjërat e mira po vijnë", ka deklaruar Benzema. "Goli i preferuar? Nuk e zgjedh, më pëlqyen që të tre", ka përfunduar Benzema. Të gjashtë golat e fundit të Real Madridit janë shënuar nga Benzema.

Tuchel: Paraqitja më e keqe në 'Stamford Bridge'

Trajneri i Chelseat, Thomas Tuchel, ka thënë se paraqitja në ndeshjen kundër Real Madridit (1-3) ishte ndër më të këqijat në epokën e tij. "Është një humbje e rëndë, një nga ndeshjet më të këqija që kam parë nga skuadra ime në 'Stamford Bridge'. Në nivele të tilla nuk mund të luash në këtë mënyrë", ka thënë Tuchel.

Klopp: Guardiola është më i miri në botë

Trajneri i Liverpoolit, Jurgen Klopp, nisi një nga javët më të rëndësishme të sezonit. Liverpooli i tij fitoi ndaj Benficës në Portugali në ndeshjen e parë të çerekfinales në Ligën e Kampionëve, një fitore për moral përpara ndeshjes me Manchester Cityn në fundjavë. Ai foli në një intervistë për "Sport Bild". "Guardiola është trajneri më i mirë në botë. Të gjithë presin këtë ndeshje mes nesh dhe tyre, dhe ne mezi presim ta luajmë. Ta studiosh Manchester Cityn është një përzierje e kënaqësisë dhe punës. Ke kënaqësi ta shohësh Cityn duke luajtur. Ne do të përgatitemi mirë dhe do të sulmojmë. Nuk mund të mbrohemi ndaj një ekipi që sulmon më shumë se kushdo tjetër", ka pohuar Klopp.

Barça preferon Lewandowskin dhe Haalandin

Barcelona është në kërkim të një golashënuesi efektiv dhe dy emrat që kryesojnë listën e klubit katalanas janë Robert Lewandowski dhe Erling Haaland. Mes të dyve më i arritshëm për klubin spanjoll duket sulmuesi i Bayern Munichit. Sipas raportimeve të "Sport", pista "Lewandowski" është më e avancuar, ndërsa prioritet deri më tani kishte qenë norvegjezi i Borussia Dortmundit dhe janë klubet e tjera në garë për 21-vjeçari, si Real Madridi dhe Manchester City, që e kanë bërë Barcelonën të fokusohet te polaku. Barça pritet ta marrë vendimin këtë prill, por tashmë është e qartë që fokusi kryesor është Lewandowski.

Verstappeni shpalos objektivin, synon t'i rrëmbejë kreun Ferrarit

Pas triumfit në garën e fundit në Arabinë Saudite, piloti holandez Max Verstappen shpreson të bëjë një tjetër garë të mirë në Australi. Këtë fundjavë do të zhvillohet gara e tretë sezonale e

Formulës 1 dhe Red Bulli konsiderohet favorit. "Mezi po pres të garoj sërish në Australi. Ka kaluar pak kohë nga hera e fundit, ndërkohë që duhen parë disa modifikime që janë kryer së fundi në pistë, të cilat

mund ta kushtëzojnë garën", u shpreh Verstappen. "Do të jetë interesante se si do të paraqitet makina në këtë pistë edhe pse duhet të ketë më shumë hapësira dhe mundësi për parakalime. Shpresoj që edhe

kjo fundjavë të jetë pozitive si ajo e Arabisë dhe të vijojmë me atë ritëm", ka deklaruar Verstappen. Sezoni 2022 i Red Bullit në Formula 1 ka qenë me hope, pasi në garën e parë pilotët e

saj u tërhoqën nga gara në xhirot e fundit, duke mos marrë asnjë pikë. Verstappeni, kampion bote në fuqi, synon të triumfojë edhe këtë vit për ta rrëmbyer titullin e dytë kampion.

C.nr.826/2017

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË, Departamenti i Përgjithshëm, me gjyqtaren Valentina Sopjani, në çështjen juridike kontestimore të paditëses Lejla Hashani nga Prishtina të cilit sipas autorizimit e përfaqëson Abit Asllani, avokat në Prishtinë, kundër të paditurit Bajram Hashani, me objekt kontesti njohjen e kontributit në bashkësinë martesore si dhe për ndarje të pasurisë të përbashkët të krijuar gjatë martesës, duke vendosur lidhur me propozimin e paditësit për caktimin e përfaqësuesit të përkohshëm, jashtë seancës gjyqësore me datë 02.02.2022 mori këtë:

AKTVENDIM

I. Të paditurit Bajram Hashani nga Prishtina, lagja Dardani, rruga Leka Dukagjini, G-1, Nr.1/1, tani me vendbanim të panjohur, jashtë vendit, i caktohet përfaqësuesi i përkohshëm Sami Brajšhori, avokat në Obiliq, me adresë në rrugën "Adem Jashari" nr.11, i cili ka për obligim që të paditurin ta përfaqësojë në procedurën civile në lëndën që udhëhiqet me shenjë C.nr.826/2017.

II. Në kuptim të nenit 82 të Ligjit të Procedurës Kontestimore (LPK), përfaqësuesi i përkohshëm i ka të gjitha të drejtat dhe detyrat e përfaqësuesit ligjor, të cilat i ushtron deri sa të paraqitet në gjykatë i padituri apo përfaqësuesi i tij me prokuror, gjegjësiat deri sa organi i kujdestarisë ta njohë gjykatën se e ka caktuar kujdestarin.

III. Ky aktvendim do të shpallet në gazetën zyrtare të Republikës së Kosovës, si dhe në tabelën e shpalljeve të gjykatës.

Arsyetim

Paditësja Lejla Hashani përmes të autorizuarit të saj Abit Asllani, avokat në Prishtinë, me datë 31.03.2017, në këtë Gjykatë, ka ushtruar padi kundër të paditurit Bajram Hashani, për njohje të kontributit në bashkësinë martesore si dhe për ndarje të pasurisë të përbashkët të krijuar gjatë martesës

I autorizuarit i të paditëses, i ka propozuar gjykatës që meqenëse i padituri, është shpërngulur nga vendbanimi në të cilin ka jetuar, të njëjtit i caktohet përfaqësues i përkohshëm ngase është e pamundur që të gjendet vendbanimi i të paditurit, në mënyrë që përfaqësuesi i përkohshëm të mbroj të drejtat e të paditurit, deri sa të gjendet i njëjti apo të autorizoj ndonjë person me qëllim që të marrë pjesë në këtë çështje kontestimore.

Gjykata duke vendosur sipas propozimit të paditësit, gjeti se janë plotësuar kushtet nga neni 79 par. 3 pika (a) të LPK-së, për caktimin e përfaqësuesit të përkohshëm për kundërshtarin e sigurimit. Andaj gjykata vendosi që kundërshtarit të sigurimit të caktohet përfaqësuesi i përkohshëm Salih Gjonbalaj avokat nga Prishtina, nga lista e avokatëve të Odës së Avokatëve të Kosovës, i cili do të përfaqësojë interesat e kundërshtares së sigurimit në këtë çështje juridiko - civile.

Nga sa u tha më lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
Departamenti i Përgjithshëm
C.nr.826/2017, me datë 02.02.2022

Gjyqtarja
Valentina Sopjani

OSNOVNI SUD - PRISHTINA

C.nr.826/2017

OSNOVNI SUD U PRISHTINI Opšte odeljenje, sa sudijom Valentinom Sopjani, u spornom pravnom predmetu tužoca Lejla Hashani iz Prishtine, koju zastupa Abit Asllani, advokat u Prishtini, protiv okrivljenog Bajrama Hashanija, sa predmetom spora priznavanje doprinosa bračnoj zajednici kao i deobi zajedničke imovine nastale tokom braka, odlučujući o predlogu tužoca za postavljanje privremenog zastupnika, van sednice suda od 02.02.2022 godine doneo je sledeće:

REŠENJE

I. Tužnom Bajram Hashani iz Prishtine, naselje Dardani, ulica Leka Dukagjini, G-1, br.1/1, sada sa nepoznatim prebivalištem, u inostranstvu, raspoređen je privremeni zastupnik Sami Brajšhori, advokat u Obiliću, sa adresom u „Adem Jashari“ ulica br. 11, koji ima obavezu da zastupa tuženog u parničnom postupku u predmetu koji se vodi pod znakom C.br.826 / 2017.

II. U smislu člana 82. Zakona o parničnom postupku (ZPP), privremeni zastupnik ima sva prava i dužnosti zakonskog zastupnika, koje ostvaruje do pojave okrivljenog ili njegovog zastupnika u sudu, odnosno dok organ starateljstva ne obavesti sud koji je imenovao staratelja.

III. Ova odluka biće objavljena u Službenom listu Republike Kosovo, kao i na oglasnoj tabli suda.

Obrazloženje

Tužnja Lejla Hashani je preko svog punomoćnika Abita Asllanija, advokata u Prishtini, dana 31.03.2017. godine, ovom sudu podnela tužbu protiv tuženog Bajrama Hashanija, za priznavanje doprinosa bračnoj zajednici i za doobu zajedničke imovine nastala tokom braka.

CYRA PER PËRFAKËSIMIN GJYQËSORË
INTERNACIONALES OMBESTELINGSBUREAU
INTERNATIONAL TRANSLATION OFFICE
BUREAU DE TRADUCTION DE LANGUES
MEDICARAGIONI KANCELARIJA ZA PREGOVORJE
Adresa: Šteti Džana Prishtina, 12000 Vukotina, ul. 114, Kosovë, tel. +383 44 44 44 44, e-mail: info@cyra.com

Punomoćnik tužoca je predložio sudu da mu se, s obzirom na to da se okrivljeni iselio iz mesta stanovanja u kome je živio, postavi privremeni zastupnik jer je bilo nemoguće pronaći mesto prebivališta tuženog, tako da privremeni zastupnik štiti prava tuženog, dok se isti ne pronađe ili ovlasti lice za učestvovanje u ovom spornom pitanju.

Sud, odlučujući o predlogu tužoca, našao da su ispunjeni uslovi iz člana 79. st. 3 tačke (a) ZPP, za imenovanje privremenog predstavnika za protivnika bezbednosti. Stoga je sud odlučio da se protivniku obezbeđenja dodeli privremeni zastupnik Salih Gjonbalaj, advokat iz Prishtine, sa liste advokata Advokatske komore Kosova, koji će zastupati interese protivnika obezbeđenja u ovom pravno-građanskom predmetu.

Iz iznetog, odlučeno je kao u odredbi ovog rešenja.

OSNOVNI SUD U PRISHTINI
Opšte odeljenje
C.br.826 / 2017, od 02.02.2022.

Sudija
Valentina Sopjani

PRAVNI SAVET: Protiv ovog rešenja žalba nije dozvoljena

CYRA PER PËRFAKËSIMIN GJYQËSORË
INTERNACIONALES OMBESTELINGSBUREAU
INTERNATIONAL TRANSLATION OFFICE
BUREAU DE TRADUCTION DE LANGUES
MEDICARAGIONI KANCELARIJA ZA PREGOVORJE
Adresa: Šteti Džana Prishtina, 12000 Vukotina, ul. 114, Kosovë, tel. +383 44 44 44 44, e-mail: info@cyra.com

REPUBLIC OF KOSOVO

C.no.826/17

BASIC COURT IN PRISTINA – BASIC COURT IN PRISHTINA, General Department, with Judge Valentina Sopjani, in the contest legal case of the plaintiff Lejla Hashani from Pristina, who according to the authorization represents Abit Asllani, lawyer in Pristina, against the respondent Bajram Hashani with contest matter recognition of contribution in the marriage, as well as for the division of joint property created during the marriage, deciding on the plaintiff's proposal for the appointment of a temporary representative, outside the court session on 02.02.2022 issued following:

RULING

I. The respondent Bajram Hashani from Pristina, Dardani neighborhood, Leke Dukagjini street, G-1, No.1/1, now with unknown residence, abroad, is assigned the temporary representative Sami Brajšhori, lawyer in Obiliq, with address in the street "Adem Jashari" no.11, which has the obligation to represent the defendant in the civil procedure in the case that is governed by the sign C.nr.826/2017.

II. Pursuant to Article 82 of the Law on Contested Procedure (LCP), the temporary representative has all the rights and duties of a legal representative, which he exercises until the defendant or his representative appears in court, e.g., until the custodial body notifies the court that it has appointed the custodian.

III. This ruling will be published in the official gazette of the Republic of Kosovo, as well as on the court announcement board.

Reasoning

Plaintiff Lejla Hashani through her representative Abit Asllani, lawyer in Pristina, on 31.03.2017, in this Court, has filed a lawsuit against the respondent Bajram Hashani, for recognition of the contribution to the marriage, and for division of the joint property of created during marriage

The respondent's representative attorney proposed to the court that since the respondent had moved from the place of residence in which he lived, he should be appointed a temporary representative because it was impossible to find the place of residence of the respondent, so that the temporary representative protect the rights of the respondent, until the same is found, or authorize a person in order to participate in this contested case.

The court, deciding on the plaintiff's proposal, found that the conditions of Article 79 paragraph 3 item (a) of the LCP, for the appointment of a temporary representative for the insurance opponent. Therefore, the court decided that the insurance opponent should be assigned the temporary representative Salih Gjonbalaj lawyer from Pristina, from the list of lawyers of the Kosovo Bar Association, who will represent the interests of the insurance opponent in this legal-civil case.

Based on abovementioned, it was decided as in the provision of this ruling.

BASIC COURT IN PRISTINA
General Department
C.no.826/17 02.02.2022

JUDGE,
Valentina Sopjani

rewith, I certify that to my best knowledge
s translation from Albanian to English is true and correct
contact me at: rigifis@gmail.com

AGIM D. HAZIRI
Prishtinë

REPUBLIKA E KOSOVËS
Republika Kosovo
Republic of Kosovo

Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

Në mbështetje të nenit 9 të Rregullores (ZKA) 03/2021 për Pranimin dhe Karrierën në Zyrën Kombëtare të Auditimit (shpallur në Gazetën Zyrtare më 16.09.2021); Zyra Kombëtare e Auditimit lëshon këtë:

NJOFTIM PËR KORIGJIM TË KONKURSIT

Me datë 06.04.2022 në faqen e internetit të ZKA-së, në Gazetën "Koha ditore" dhe "Epoka e Re" është shpallur Konkursi për vendin e punës "Përkthyes – nga gjuha shqipe në gjuhë serbe dhe anasjelltas" me numër të referencës PSA/ZKA/09-04/22. Konkursi përmban një gabim teknik prandaj me qëllim të korigjimit të këtij gabimi, pika 2 tek pjesa Detyrat dhe përgjegjësitë, formulohet me tekstin si në vijim:

"Bën përkthimin e dokumenteve nga gjuha shqipe në gjuhën serbe dhe anasjelltas sipas normativit të përcaktuar për një ditë pune. Normativi mesatar për përkthim të dokumenteve brenda një ditë pune përfshinë mesatarisht 2000 fjalë"

Të gjitha pjesët e tjera të publikuara në konkursin e datës 6 prill 2022 mbeten të pandryshuara.

Kërkojmë mirëkuptimin tuaj!

Me 07.04.2022, Prishtinë

Departamenti për Buxhet dhe Burimeve Njerëzore

Na osnovu člana 9 Pravilnika (NKR) 03/2021 o Prijemu i Karijeru u Nacionalnu Kancelariju Revizije (objavljena u Službenom listu 16.09.2021.); Nacionalna Kancelarija Revizije izdaje ovo:

OBAVEŠTENJE ZA ISPRAVKU KONKURSA

Dana 06.04.2022.godine na veb stranici NKRA, u novinama „Koha ditore“ i „Epoka e Re“ objavljen je konkurs za „Prevodioca – sa albanskog na srpski i obrnuto“ sa referentnim brojem PSA/ZKA/09-04/22. Konkurs sadrži tehničku grešku, pa je u cilju otklanjanja ove greške tačka 2 u odeljku Dužnosti i odgovornosti formulisana sledećim tekстом:

"Vrši prevod dokumenta sa albanskog na srpski i obrnuto prema normi utvrđenoj za radni dan. Prosečna norma za prevodenje dokumenta u toku radnog dana obuhvata u proseku 2000 reči"

Svi ostali delovi objavljeni na konkursu 6. aprila 2022. ostaju nepromenjeni.

Molimo za razumevanje!

Na 07.04.2022, Prishtina

Dpartman za Buđet i Ljudske Resurse

Translation: Albanian-English

REPUBLIC OF KOSOVO

C.nr.101 / 22

